

1 E mërkurë 14 korrik 2021

2 [Konferenca për Ecurinë e Çështjes]

3 [Seancë e hapur]

4 [I akuzuari nuk është i pranishëm në sallën e
5 gjyqit]

6 --- Fillon në orën 15:04

7 GJYKATËSI GUILLOU: [përkthim] Mirëdita dhe mirë se
8 erdhët të gjithëve brenda dhe jashtë sallës së gjyqit.

9 Znj. Sekretare e Gjykatës, ju lutem shpallni çështjen.

10 SEKRETARJA E GJYKATËS: [përkthim] I nderuar Gjykatës,
11 kjo është çështja KSC-BC-2020-07, Prokurori kundër Hysni
12 Gucatit dhe Nasim Haradinajt.

13 GJYKATËSI GUILLOU: [përkthim] Faleminderit Z. Sekretare.

14 Tani u lutem palëve që të prezantohen duke filluar me
15 Zyrën e Prokurorit të Specializuar.

16 Z. Prokuror.

17 Z. PACE: [përkthim] Mirëdita, i nderuar Gjykatës,
18 përshëndet të gjithë të pranishmit në sallë dhe jashtë saj. Në
19 emër të Prokurorisë sot ndodhen të pranishëm Alex Whiting,
20 Zëvendës Prokuror i Specializuar, Matt Halling, Asistent
21 Prokuror; Valeria Bolici, Prokurore, Line Pedersen, Menaxhere
22 e Çështjes dhe unë jam James Pace, Ndhmës Prokuror.

23 GJYKATËSI GUILLOU: [përkthim] Faleminderit, Z. Prokuror.

1 I kthehem tani Mbrojtjes, nuk e di nëse do të fillojmë
2 me Z. Rees apo do të fillojmë me Z. Bowden se më duket se ka
3 pasur një problem për sa i takon lidhjes me Z. Rees. Cili do -
4 nga të dy ka fjalën?

5 Z. REES: [përmes telekonferencës][përkthim] I nderuar,
6 jam Jonathan Rees. Po lidhem me këtë seancë përmes Zoom-it nga
7 larg, asistohem nga Z. Bowden, bashkë-avokat dhe Z. Ellie
8 Stephenson është i pranishëm për të asistuar, përfaqësojmë Z.
9 Hysni Gucati.

10 GJYKATËSI GUILLOU: [përkthim] Faleminderit shumë Z.
11 Rees. Jam në dijeni që janë bërë disa ndryshime të fundit të
12 paparashikuara për sa i takon vendndodhjes suaj për të ndjekur
13 këtë seancë nga larg. Nëse keni ndonjë problem për të ndjekur
14 debatet, diskutimet apo nëse keni nevojë që tua përsërisim
15 ndonjë fjali, mos nguroni që të kontaktoni Sekretarinë e
16 Gjykatës.

17 Z. REES: [përmes telekonferencës][përkthim] Faleminderit
18 shumë dhe ju jam shumë mirënjohës që më lejuat që të marr
19 pjesë pa video, siç jam në këto kushte, në këto rrethana të
20 jashtëzakonshme. Edhe një herë ju falënderoj.

21 GJYKATËSI GUILLOU: [përkthim] Ju lutem.

22 I drejtohem tani Z. Cadman.

23 Z. CADMAN: [përkthim] Mirëdita, i nderuar Gjykatës, Z.
24 Cadman, përfaqësues i Z. Nasim Haradinaj personalisht.

25 Z.BUCKLEY na bashkohet në distancë, është bashkë-avokati Z.

1 Boxberg është bashkë me mua këtu në sallë, është asistent
2 juridik.

3 GJYKATËSI GUILLOU: [përkthim] Faleminderit, Z. Cadman
4 Tani i kthehem Zyrës së Administrimit.

5 Z. ROCHE: [përkthim] Mirëdita, i nderuar Gjykatës, jam
6 Ralph Roche, Shefi i Shërbimeve Gjyqësore, bashkë me mua është
7 edhe Zëvendës i - Administratorja --

8 GJYKATËSI GUILLOU: [përkthim] Faleminderit shumë. Unë
9 jam një koleg i juaj, Gjykatësi [e padëgjueshme] paraprahe.

10 Më datë 9 qershor caktova datën për sa - për Konferencën
11 e gjashtë për Ecurinë e Çështjes për këtë çështje. Më 23
12 qershor e ndryshova datën për këtë seancë kur urdhërova
13 dorëzomini e aktakuzës së korrigjuar pas vendimit të Gjykatës
14 së Apelit, mbi mocionin paraprahe të dorëzuar nga mbrojtja. Më
15 5 korrik ZPS-ja dorëzoi aktakuzën e korrigjuar, më 12 korrik
16 avokatët e Z. Gucati dhe Z. Haradinaj dorëzuan dosjet
17 paraprahe përkatëse.

18 Për sot kam qëllim që të shqyrtojmë ecurinë e çështjes
19 përpara se ta kalohet çështja -- dosja e çështjes, më falni,
20 Trupit Gjykues, për të -- të afatit për të cilin e kanë
21 vendosur në urdhrin për kalendarin e shkuar si data, 16
22 korrik.

23 Në veçanti dëshiroj që të diskutojmë për objektet --
24 objektin e paraburgimit, për përkthimet, për nxjerrjen e
25 materialeve, për ecurinë e hetimeve të mbrojtjes dhe për

1 kalimin e dosjes gjyqësore dhe për gatishmërinë për procesin
2 gjyqësor.

3 E falënderoj mbrojtjen e Z. Haradinaj për parashtrimin e
4 tyre me shkrim, si zakonisht, u kujtoj palëve se nëse kanë
5 nevojë që parashtrimet e tyre -- të nxjerrin informacione
6 konfidenciale, mund të -- duhet të na e thonë këtë gjë që të
7 kalojmë në seancë private apo të mbyllur.

8 Sot dëshiroj që të fillojmë me një përditësim nga ana e
9 Zyrës së Administrimit lidhur me masat që janë marrë sa i
10 takon komunikimit midis avokatëve të mbrojtjes dhe klientëve
11 të tyre në objektin e paraburgimit.

12 Vë re se pavarësisht nga pranimi i marrjes së hapave nga
13 ana e Zyrës së Administrimit për të përmirësuar situatën sa i
14 takon -- me futjen dhe instalimin e ekraneve të kompjuterëve,
15 avokatët mbrojtës të Z. Haradinaj vijojnë që të shprehin
16 shqetësimet e tyre të mëparshme lidhur me komunikimin midis
17 avokatëve dhe të akuzuarve.

18 I ftoj palët që të na thonë se cilat janë masat më të
19 fundit të zbatuara nga Zyra e Administrimit dhe nëse këto u
20 përgjigjën shqetësimeve të tyre.

21 Gjithashtu dëshiroj që Zyra e Administrimit të na
22 përditësojë lidhur me mundësinë për të organizuar vizitat e
23 familjeve, duke pasur parasysh zhvillimin e pandemisë Covid-19
24 dhe fushatën e vaksinimit.

25 Z. ROCHE: [përkthim] I nderuar zoti Gjykatës, ju

1 falënderoj shumë. Gjatë gjithë pandemisë ne kemi punuar nga
2 afër me nëpunësin mjekësor në objektin e paraburgimit dhe me
3 palët përkatëse. E kam për kënaqësi t'ju them që duke filluar
4 nga data 1 korrik, vizitat mund të bëhen sigurisht në objektet
5 e paraburgimit por edhe pa ndarje, domethënë pa ndarje me qelq
6 apo pleksiglas dhe pa veçim fizik. Për sa kohë që të - kjo
7 vlen për të gjithë ata -- pra edhe për -- për avokatët të
8 cilët janë të vaksinuar plotësisht, apo që vijnë nga vende me
9 kod të gjelbër dhe të verdhë.

10 Duke filluar nga data 16 korrik, ky relaksimi i
11 rregullave për popullsinë në Holandë është zbatuar së bashku
12 me një sërë masash të tjera. Ne gjithashtu kemi marrë edhe
13 masa për t'u dhënë mundësi avokatëve që jo vetë të shihen me
14 ata përmes ekraneve, etj., por edhe të takohen fizikisht.

15 Sa i takon vizitave të familjeve, duke ndjekur nga afër
16 këshillat mjekësore, vizitat e familjeve nga afër, pra në
17 mjediset e paraburgimit, mund të fillojnë që nesër dhe janë
18 planifikuar ose pritët që të zhvillohen. Pra edhe një herë, e
19 përsëris që janë të mundshme vizitat e familjarëve nga afër.

20 GJYKATËSI GUILLOU: [përkthim] Faleminderit shumë.

21 Tani i jap fjalën Mbrojtjes, sidomos për të na thënë
22 nëse kanë akoma probleme apo shqetësime lidhur edhe pas
23 marrjes së këtyre masave.

24 Z. Rees, fjala për ju.

25 Z. REES: [përmes telekonferencës][përkthim] Jemi

1 mirënjohës për masat e marra deri tani, ato vërtetë ndihmojnë.
2 Ne mezi presim që të jemi në gjendje që të takohemi nga afër,
3 ballë-për-ballë pa asnjë pengesë fizike midis avokatit të
4 Mbrojtjes dhe klientit.

5 Ne jemi në dijeni se ky është një hap i cili do të
6 merret shumë shpejt dhe mezi presim që të bëhet kjo gjë. Ka
7 edhe masa që po merren për planifikuar vizitat e familjarëve.
8 Jemi mirënjohës për këtë dhe mezi presim që të fillojmë edhe
9 vizitat e familjare me klientët tanë sa më shpejtë. Nuk kam
10 gjë tjetër për të shtuar. Faleminderit.

11 GJYKATËSI GUILLOU: [përkthim] Faleminderit shumë Z.
12 Rees.

13 Z. Camdan.

14 Z. CADMAN: [përkthim] Faleminderit i nderuar Gjykatës,
15 edhe unë dëshiroj të falënderoj Zyrën e Administrimit për
16 masat që kanë marrë sepse kjo ka sjellë një ndryshim shumë të
17 madh. Edhe unë mund të them se kam bërë vizitën e parë dje dhe
18 sot me Z. Haradinaj dhe po kështu patën mirësinë të më
19 tregonin të gjitha masat e marra për të përmirësuar kushtet
20 për vizitat midis familjarëve dhe klientët dhe të akuzuarit.

21 Ka ende një ndarje me qelq në tryezë dhe e kuptojmë
22 këtë. Sigurisht, Z. Haradinaj e mirëpret marrjen e këtyre
23 hapave.

24 Është sigurisht diçka jo e mirë që këto hapa merren
25 vetëm tani në këtë fazë kur çështja po bëhet gati për t'i

1 kaluar Trupit Gjykses, por gjithsesi, e kuptojmë këtë gjë.

2 Kritikë që kam bërë në parashtrimet me shkrim është bërë
3 përpara se unë të vizitoja objektin e paraburgimit dhe kjo
4 ishte kryesisht se edhe -- pra përdorim përpara sistemit
5 telefonik. Tani është zgjidhur, ka dy ekrane apo dy perde në
6 sallë. Kjo është diçka të cilën nuk mund ta parashikojmë si
7 zhvillim në të ardhëm. Jo më larg se dje morëm vesh se Holanda
8 mund të kalojë në situatën kur merr kodin portokalli apo madje
9 edhe të kuq dhe kjo mund të na rikthejë në një situatë më të
10 përkeqësuar sa i takon pandemisë me masat e marra që më
11 përpara.

12 Vizitat familjare janë tejet të rëndësishme. Ne jemi
13 shumë mirënjohës që po merren masat për këtë. Z. Haradinaj po
14 bëhet dhjetë muaj që ndodhet në paraburgim pa pasur mundësi që
15 të takohet me familjarët. Ne jemi në dijeni se Ministria e
16 Drejtësisë ka kërkuar vizita me të ndaluarit të cilat janë
17 refuzuar për një arsye ose një tjetër. Edhe këto çështje duhen
18 mbajtur parasysh. Sigurisht situata që kemi tani na jep
19 mundësi që të ulemi me klientët tanë dhe të shfletojmë
20 dokumente dhe të diskutojmë çështje. Kjo do të thotë se do të
21 na duhet dhe pak më shumë kohë që të jemi gati për të kaluar
22 në procesin gjyqësor.

23 Sigurisht ne nuk kërkojmë që t'i vonojmë kohët më tej
24 sidomos nga ana e Z. HARADINAJ, duke pasur parasysh që po
25 bëhen dhjetë muaj që ndodhet në paraburgim, ai mezi pret që

1 gjërat të ecin përpara dhe jo të vonohen më tej.

2 GJYKATËSI GUILLOU: [përkthim] Faleminderit shumë, Z.

3 Cadman.

4 Z. Roche, a dëshironi të thoni ndiçka sa u takon
5 vizitave konsullore, se është diçka që është ngritur edhe nga
6 Z. CADMAN.

7 Z. ROCHE: [përkthim] I nderuar Gjykatës, vizitat
8 konsullore do të fillojnë fizikisht, pra nga afër, që nesër me
9 sa jam në dijeni, data 15 korrik.

10 GJYKATËSI GUILLOU: [përkthim] Faleminderit shumë.

11 Nuk e di Prokuroria a ka diçka për të shtuar lidhur me
12 këtë? Ma merr mendja jo? Faleminderit, atëherë, Z. Prokuror.

13 Kalojmë tani tek pika e dytë në rendin e ditës që janë
14 përkthimet. Në veçanti nëse mbeten ende shqetësime nga ana e
15 Mbrojtjes sa u takon përkthimeve që kërkohen me ligj.

16 Së pari dëshiroj që të dëgjoj nga Zyra e Administrimit
17 lidhur me situatën e tanishme sa i takon përkthimeve në këtë
18 çështje gjyqësorë dhe nëse ka ende dokumente të cilët ende
19 duhet të përkthehen apo të rishikohen. Pastaj dëshiroj që të
20 dëgjoj nga palët nëse mbeten ende disa vështirësi sa u takon
21 përkthimeve.

22 Në këtë aspekt vë re se avokatët e mbrojtjes së Z.
23 Haradinaj ka shprehur shqetësimin se disa dokumente nuk janë
24 përkthyer. I kërkoj mbrojtjes së Z. Haradinaj që të tregojë
25 nëse ka ende parashtrime apo materiale të cilat mbeten për t'u

1 përkthyer në shqip sipas vendimit për gjuhën e punës dhe sipas
2 vendimit kornizë për nxjerrjen e materialeve.

3 Z. ROCHE, fjalën e keni ju.

4 Z. ROCHE: [përkthim] Faleminderit shumë, i nderuar
5 Gjykatës.

6 Sa u takon përkthimeve, nuk ka përkthime të mbetura pa
7 bërë, sipas ligjit. Siç është thënë edhe në Konferencën e
8 mëparshme për Ecurinë e Çështjes, këto janë siguruar tashmë,
9 që para datës 15 qershor edhe aktakuza e rishikuar është pra
10 një aktakuzë disi e rishikuar dhe dokumentet e tjera janë
11 dorëzuar nga ZPS-ja dhe përkthimet e përditësuara janë vënë në
12 dispozicion javën që shkoi.

13 Sa i takon përkthimeve të tjera të cilat kërkohen nga
14 Mbrojtja, nuk ka, më saktë, përkthime prioritare që kërkohen
15 nga Mbrojtja në këtë çështje. Ashtu si edhe në çështje të
16 tjera, ato do të parashtrohen - dorëzohen automatikisht me
17 ecurinë e kohës, sipas politikës së përshtatshme.

18 GJYKATËSI GUILLOU: [përkthim] Faleminderit. Fillojmë
19 tani me Mbrojtjen, Z. REES.

20 Z. REES: [përmes telekonferencës][përkthim] Unë jam në
21 dijeni që Z. Cadman ka hartuar parashtime të hollësishme me
22 shkrim për këtë çështje. E falënderoj. E pranoj qëndrimin e
23 tij dhe do të mbaj të njëjtin qëndrim si ai.

24 GJYKATËSI GUILLOU: [përkthim] Faleminderit, Z. Cadman,
25 ç'keni për të thënë?

1 Z. CADMAN: [përkthim] I nderuar Gjykatës, nuk do të
2 përsëris ato që kam thënë me shkrim, por duket se nuk
3 përputhemi në mendim lidhur me atë se çfarë kërkohet me ligj
4 dhe çfarë kanë të drejtë të marrin të akuzuarit.

5 Unë e kam bërë shumë të qartë se bëhet fjalë për një
6 institucion të Republikës së Kosovës. Të akuzuarit -- i
7 akuzuari është shtetas i Republikës së Kosovës dhe ka të
8 drejtën që të gjitha materialet t'i marrë në gjuhën që ai e
9 kupton, të gjitha materialet që do të përdorë Prokuroria.

10 Kur flasim se çfarë kërkon ligji dhe cilat janë
11 materialet që duhet të përkthehen unë -- është diçka të cilën
12 ne nuk e pranojmë si të mjaftueshme. Ne do të bëjmë një
13 parashtrim me shkrim lidhur me ato dokumente të cilat
14 konsiderohen si të pa përkthyer ende deri tani. Ne e kuptojmë
15 që ka një prioritet lidhur me këtë çështje por nuk mund të
16 ecet përpara me këtë qëndrim dhe nuk mund të vazhdojmë nëse
17 nuk mund do të vendosen në dispozicion të të akuzuarit në
18 gjuhën që ai flet dhe kupton.

19 Ne e kuptojmë se nuk bëhet fjalë për një shtetas të huaj
20 që del përpara një gjykate të huaj. Është një shtetas i një
21 vendi që del përpara gjykatës së shtetit të tij, pa çka se kjo
22 gjykatë është e pajisur me personel ndërkombëtar. Prandaj, të
23 gjitha materialet duhet të jepet në gjuhën që ai kupton, sepse
24 i akuzuari ka nevojë që të japi udhëzime avokatit mbrojtës dhe
25 këtë gjë ai nuk e bën nëse materialet nuk i ka në gjuhën e

1 tij.

2 I akuzuari duhet që të ketë mundësi t'i shikojë të
3 gjitha këto materiale dhe kjo çështje nuk mund të fillojë të
4 gjykohet pa u arritur kjo gjë dhe ne i qëndrojmë këtij
5 qëndrimi.

6 Nëse do të mund t'ju ndihmonim ne mund të bënim një
7 parashtrim shtesë dhe të gjitha materialet që ne kërkojmë që
8 të përkthehen në mënyrë që kjo çështje të eci përpara.

9 GJYKATËSI GUILLOU: [përkthim] Faleminderit Z. Cadman.

10 Për të kuptuar qëndrimin tuaj lidhur me këtë temë, pra
11 ju në thelb po më thoni se nuk pajtoheni me vendimin tim si
12 për gjuhën e punës ashtu edhe Vendimin Kornizë për Nxjerrjen e
13 Materialeve, sidomos paragrafët nga 61 deri në 64, ku unë kam
14 papërcaktuar të gjitha dokumentet të cilat duhen përkthyer dhe
15 unë kam përcaktuar edhe procedurën që duhet të ndjekë Mbrojtja
16 apo palët për ta kundërshtuar këtë gjë dhe se si mund të
17 zgjidhet? Apo pajtoheni me këtë kornizë dhe bëhet fjalë vetëm
18 për ekzekutimin e përkthimit nga ana e Zyrës së Administrimit
19 që shqetësim për ju. Dhe nëse është kjo e fundit, atëherë,
20 specifikisht për cilin dokument e keni fjalën? Është ndonjë
21 dokument i veçantë apo në përgjithësi?

22 Z. CADMAN: [përkthim] I nderuar Gjykatës, siç e kemi
23 thënë ë parë, vendimi për gjuhën e punës është marrë përpara
24 se unë të caktohesha si mbrojtës në këtë çështje. E di që
25 vendimi është marrë në fillim të procedurave.

1 Qëndrimi ynë që ka dokumente, të cilat me kënaqësi do
2 t'ju a paraqisja me shkrim, pra dokumentet që ne mendojmë se
3 duhen përkthyer. Mund të ndodhë që t'u kthehemi përsëri këtyre
4 çështjeve. Qëndrimi ynë është që nuk është e mjaftueshme që
5 të përqendrohemi vetëm tek dokumentet bazë, të cilat i
6 pandehuri ka të drejtë t'i shohë.

7 Është e gjithë dosja, gjithë materiali i dosjes që duhet
8 përkthyer.

9 GJYKATËSI GUILLOU: [përkthim] Z. Cadman, në vendimin tim
10 kuadër për këtë çështje që mban datën 22 janar 2021, pasi ju
11 jeni caktuar si mbrojtës, tek paragrafi 64 kam thënë se:

12 "Mbrojtja mund të kërkojë gjithashtu nga ZPS-ja të japë
13 përkthime në shqip të provave të caktuara apo pjesëve të tyre,
14 apo të deklaratave të dëshmitarëve që ZPS-ja synon t'i
15 thërresë për dëshmi në gjyq. Kur bën kërkesa të tilla,
16 mbrojtja duhet të paraqesë arsyet se përse është me rëndësi
17 për të që t'i marrë këto dëshmi në shqip dhe përse i akuzuari
18 nuk mund të vlerësojë përmbajtjen e tyre me ndihmën e një
19 përkthyesi dhe me këshillat e mbrojtësit. Në rast mospajtimi
20 midis mbrojtjes dhe ZPS-së për këtë gjë, mbrojtja duhet t'i
21 drejtohet Gjykatësit të Procedurës Paraprake sa më shpejtë të
22 që jetë e mundur".

23 Nuk mendoj se konferenca e fundit për Statusin e
24 Çështjes, dy ditë përpara datës që unë kam thënë se do ta
25 kaloja çështjen para trupit gjyqësor, i korrespondon fjalës

1 "sa më shpejtë që të jetë e mundur". Pra vendimi im ishte
2 shumë i qartë. Përse nuk i keni kërkuar ZPS-së ato pjesë
3 provash. Mund të ishin edhe një mijë të tilla, por vendimi
4 është marrë -- është dhënë që në shkurt, më falni në janar.

5 Z. CADMAN: [përkthim] Është e saktë, nuk është hera e
6 parë që e kemi ngritur si çështje. Në fakt, është hera e
7 tretë.

8 Në një rast kur e pyetëm ZPS-në lidhur me përkthimin e
9 dokumenteve në shqip, na thanë se nuk është përgjegjësia e
10 tyre. Nuk është përgjegjësia e tyre të na japë përkthimet.
11 Pastaj ngritëm çështjen me Zyrën Administrative, na thanë se
12 do të na duhen tre muaj për t'i marrë. Pastaj u përshpejtua
13 puna dhe i morëm dokumentet.

14 Për fat të keq ky është procesi, unë e vlerësoj faktin
15 që shumë nga këto çështje duhet të ishin ngritur më parë. Nuk
16 i kemi ngritur. Nuk e dinim atëherë, dhe me kalimin e kohës
17 janë nxjerrë dokumente të tjera, por tani mund të them vetëm
18 se në qoftë se kërkohet parashtrim më tejshëm për të
19 identifikuar dokumente që na quhen të rëndësishëm, ne do ta
20 bëjmë menjëherë. Kur them "menjëherë", sa më shpejtë përpara
21 16 korrikut e kam fjalën.

22 GJYKATËSI GUILLOU: [përkthim] Ka rëndësi që ju të vini
23 në dukje me saktësi dokumentin apo dokumentet që mendoni se
24 duhen përkthyer për t'i parë Z. Haradinaj.

25 Z. Prokuror, keni diçka për të thënë lidhur me këtë

1 çështjen e përkthimit?

2 Z. PACE: [përkthim] Po, shkurt. Sa për të sqaruar
3 kërkesën që kemi marrë, kishte të bënte me përkthimin e dosjes
4 para gjyqësore. Përgjigja jonë ishte që nuk e kishim për
5 detyrë, duke e ditur shumë mirë se këtë punë do ta bënte Zyra
6 Administrative. Përveç kësaj, nuk kemi marrë ndonjë kërkesë
7 për përkthim. Nuk ka nevojë ta them sepse ne e dimë që të
8 gjitha dokumentet që janë nxjerrë dhe shumica e tyre janë edhe
9 në shqip edhe në anglisht. Për shembull provat me video, për
10 të cilat kemi prova me video, ku është zëri në shqip dhe
11 transkriptimi që është në shqip.

12 Ndryshe, po, ka një -- me sa duket [ka] mendime të
13 ndryshme midis palëve. Por ne po bëjnë atë që duhet sipas
14 ligjit dhe rregullores.

15 Dhe mendoj që nuk duhet të ketë vonesë, qoftë për
16 kalimin e çështjes përpara Trupit Gjyqësor apo për shkak të
17 përkthimeve, kur është e qartë se mbrojtjes i është dhënë
18 materiali i duhur i përkthyer.

19 GJYKATËSI GUILLOU: [përkthim] Faleminderit, Z. Prokuror.

20 Z. Roche, a mund të shtoni -- doni të shtoni diçka për
21 këtë temë? Mbase për kërkesën që keni marrë nga mbrojtja,
22 gjatë muajve të kaluara dhe çfarë materialesh i keni dhënë
23 përparësi.

24 Z. ROCHE: [përkthim] Faleminderit.

25 Kërkesën që kemi marrë ishte për dosjen para gjyqësorë

1 që ne e kemi dhënë përgjigjen tonë lidhur me afatet se kur
2 mund t'i jepnim ato, duke marrë parasysh kohën e rishikimit që
3 kërkohet. Pra i kemi bërë përkthimet që ishin më përparësore
4 të dokumenteve që u kërkuan dhe në rastin se do të marrim
5 kërkesa të tjera për prioritarizim në përputhje me politikat
6 tona, do të përcaktojmë kriteret për të përcaktuar cilat
7 dokumente janë më përparësore.

8 GJYKATËSI GUILLOU: [përkthim] Faleminderit, Z. ROCHE.

9 Z. Rees, keni diçka për të shtuar për këtë temë?

10 Z. REES: [përmes telekonferencës][përkthim] Jo, i
11 nderuar Gjykatës.

12 GJYKATËSI GUILLOU: [përkthim] Z. Rees, sikurse i thashë
13 edhe Z. CADMAN, nëse keni ndonjë përkthim të mbetur që ju
14 duhet ta përktheni, ju lutem njoftojeni këtë sa më herët që të
15 ketë mundësi, me qëllim që Zyra e Administratës t'i japë
16 përparësi kësaj çështjeje.

17 Z. REES: [përmes telekonferencës][përkthim] Do ta bëjmë.

18 GJYKATËSI GUILLOU: [përkthim] Z. Cadman, keni ndonjë gjë
19 për të shtuar për këtë temë?

20 Z. CADMAN: [përkthim] Dua vetëm të them se në
21 kundërshtim me atë që tha ZPS-ja, nuk kërkojmë që ta vonojmë
22 çështjen. Thjeshtë duam që përpara se të vemi në gjyq, të
23 marrim ato materiale që nuk janë përkthyer.

24 GJYKATËSI GUILLOU: [përkthim] Faleminderit. E mora
25 parasysh.

1 Të kalojmë tani tek pika tjetër që ka të bëjë me
2 nxjerrjen e materialeve. Së pari, dua të di nëse Prokuroria e
3 ka finalizuar - dhe më këtë kam parasysh vërtetë finalizuar -
4 nxjerrjen e dokumenteve apo mendon se ka materiale të tjera të
5 cilat duhet t'ja bëjë të njohura mbrojtjes. Nëse është kjo e
6 fundit, dua që ZPS-ja të na shpjegojë se cilat materiale duhen
7 nxjerrë dhe arsyet për vonesën e nxjerrjes së tyre.

8 Gjithashtu, dua të dëgjoj nga Prokuroria nëse do të
9 kërkojnë masa mbrojtëse për ata dëshmitarë që do të thirren
10 për të dëshmuar në këtë çështje. Ky informacion do të
11 përfshihet në dokumentin e dorëzimit.

12 Së fundi, dua të dëgjoj nga mbrojtja për këtë temë,
13 veçanërisht nëse ata përballen me vështirësi të tjera të
14 lidhura me procesin e nxjerrjes së materialeve. Dhe për këtë i
15 bëj thirrje mbrojtjes të përqendrohet te vështirësitë e
16 mbetura sepse kemi diskutuar shumë herë. Kam dhënë shumë
17 vendime për këtë. Nuk ka nevojë që të flasim për historinë
18 procedurale të nxjerrjes së dokumenteve por për atë që mbetet
19 ende për t'u diskutuar.

20 Keni fjalën, Z. Prokuror.

21 Z. PACE: [përkthim] Do të flas së pari për masat
22 mbrojtëse. E di që në dosjen paraprake ne e kemi vënë në dukje
23 se me kohë do të bëjmë kërkesa në lidhje me masa mbrojtëse për
24 dëshmitarët tanë dhe jemi duke bërë vlerësimin e çështjes dhe
25 do ta bëjmë kërkesën sigurisht në kohën e duhur përpara se të

1 fillojë -- përpara trupit gjykues.

2 Në lidhje me nxjerrjen e dokumenteve, ka shumë dokumente
3 të kërkuara nga mbrojtja të cilat aktualisht - në këtë moment
4 nuk duam të nxjerrim informacion tjetër. Nuk planifikojmë pra
5 ta bëjmë këtë. Do t'ju kujtoj juve dhe mbrojtjen kur të kemi
6 dokument. Ka një kërkesë që nuk është zgjidhur ende e palës së
7 tretë. Presim një përgjigje dhe shpresojmë. Po presim që ta
8 bëjmë këtë në fund të korrikut. Sigurisht çdo informacion të
9 marrë do ta bëjmë të njohur menjëherë. Nuk besojmë se do të
10 kërkojmë redaktime apo çështje që kanë të bëjnë me rregullin
11 107. Do të bëjmë ç'është e mundur por si gjithmonë varemi në
12 një farë mase nga palët e tjera, të jashtme.

13 Kaq kisha për të thënë për këtë çështje.

14 GJYKATËSI GUILLOU: [përkthim] Që ta dëgjojë edhe
15 mbrojtja, e keni fjalën për pjesën e dytë të kërkesës që
16 presim, që kemi në fakt disa javë apo muaj të themi që të
17 marrim përgjigje.

18 Faleminderit shumë, Z. Prokuror.

19 Tani i drejtohem mbrojtjes.

20 Z. Rees.

21 Z. REES: [përmes telekonferencës][përkthim] Ne para
22 shikojmë të kemi vështirësi lidhur me nxjerrjen e materialeve.
23 Nuk po i kthehem kronologjisë, sepse ju e dini më së miri, por
24 nuk kemi shumë besim se gjërat do të përmirësohen që tani e
25 tutje.

1 Mbetet një apel i pazgjidhur lidhur me nxjerrjen e
2 mëparshme për të cilin presim vendimin tuaj edhe pse të gjitha
3 parashtrimet e të gjitha palëve janë përpara Panelit të
4 Gjykatës së Apelit. Edhe pse parashikojmë vështirësi të
5 vazhdueshme për nxjerrjen, në varësi të një çështjeje që Z.
6 Cadman do ta ngrejë në seancë të mbyllur, nuk sugjerojmë që
7 vështirësitë e vazhdueshme të nxjerrjes duhet ta pengojnë
8 transferimin apo kalimin e dosjes përpara Trupit Gjykses.

9 Çdo çështje tjetër nxjerrjeje duhet zgjidhur nga Trupi
10 Gjykses në kohën e duhur. Lidhur me kërkesën e mbetur nga pala
11 e tretë, do të na ndihmonte nëse Z. PACE do të na jepte një
12 përmbledhje të llojit të materialit që pritet. Vëllimi i
13 materiali që pritet, sepse kjo do të na ndihmonte që të bënim
14 planifikimin e fazës së ardhshme. Pra kur palët do të jenë
15 gati për gjyq.

16 Ndryshe nuk kam gjë për të shtuar në këtë fazë, i
17 nderuar Gjykatës.

18 GJYKATËSI GUILLOU: [përkthim] Faleminderit, Z. REES. E
19 kam mbajtur shënim këtë që thatë. Përpara se t'i jap fjalën
20 Prokurorit, po i jap fjalën Z. Cadman.

21 Z. CADMAN: [përkthim] Faleminderit, i nderuar Gjykatës.

22 Nuk ka shumë kuptim që të përsëris ato që tha Z. REES.
23 Ne i kemi parashtruar këto në parashtrimet tona me shkrim se
24 nuk kemi shumë besim, për të mos thënë se nuk kemi fare, për
25 zgjidhjen e kësaj çështjes. Se ne parashikojmë pengesa të reja

1 gjatë rrugës.

2 Por shpresojmë që këto pengesa nuk do të jenë aq të
3 mëdha sa të ndërpresin ecurinë e çështjeve këtu. E kemi fjalën
4 për qëndrimin prej kavalieri të ZPS-së lidhur me detyrimin që
5 ka për të nxjerrë materiale. Ka një problem, apo dy në fakt,
6 por jam pajtuar që të mos i ngre këto në seancë publike,
7 prandaj këto dy çështje do t'i trajtoj në seancë të mbyllur.

8 GJYKATËSI GUILLOU: [përkthim] E mbajta shënim.

9 Në qoftë se jeni dakord, këtë gjë mund ta bëjmë pas
10 pikës së fundit të kësaj konference, kur unë them "çështjet e
11 tjera" dhe besoj që nuk është në seancë private,

12 Z. CADMAN: [përkthim] Jo. Unë shpjegova në fakt
13 ndryshimin midis seancës private dhe publike.

14 GJYKATËSI GUILLOU: Sepse duhet të jemi sa më publikë që
15 të jetë e mundur, që publiku të ketë mundësi të dëgjojë dhe të
16 shohë se ç'zhvillohet. Pra në qoftë se kam mundur gjithmonë
17 është më mirë që të futemi në seancë të mbyllur dhe jo
18 private.

19 Z. CADMAN: [përkthim] Pra ato perdet mund të rrinë të
20 mbyllura apo mund të ngrihen sipas rastit.

21 GJYKATËSI GUILLOU: [përkthim] Tani po ja jap fjalën
22 prokurorisë, në qoftë se doni që të futemi në seancë private
23 për t'ju përgjigjur? Jo? Pra e shoh që s'paska nevojë. Atëherë
24 e keni fjalën.

25 Z. PACE: [përkthim] Lidhur me kërkesën e Z. Rees për t'i

1 dhënë informacion, lidhur me materialet dhe vëllimin e tyre
2 mund të them që Gjykatësi i seancës paraprahe është i
3 informuar lidhur me natyrën e kësaj çështjeje të këtyre
4 materialeve.

5 GJYKATËSI GUILLOU: [përkthim] Faleminderit shumë, Z.
6 Prokuror.

7 Z. Rees, dëshironi të shtoni diçka?

8 Z. REES: [përmes telekonferencës][përkthim] Nën dritën e
9 përgjigjes që mora nuk dua të shtoj asgjë.

10 GJYKATËSI GUILLOU: [përkthim] Faleminderit, Z. REES.

11 Z. Cadman, doni të shtoni diçka?

12 Z. CADMAN: [përkthim] I nderuar, çështja e vetme që
13 duhet zgjidhur në lidhe me nxjerrjen e materialeve ndikon
14 shumë te hetimet e mbrojtjes. Pra do të diskutoj kur të
15 diskutojmë këtë çështje.

16 GJYKATËSI GUILLOU: [përkthim] E mora shënim.

17 Kalojmë tek pika tjetër e programit që ka të bëjë me
18 hetimet e mbrojtjes, po ftoj mbrojtjen të na japë -- të
19 propozojë një datë -- a më fal -- përditësime për statusin e
20 hetimeve duke përfshirë sasinë e përgjithshme dhe llojin e
21 provave që ka synim të bëjë të njohura për ZPS-në dhe nëse
22 kërkesat për masa për masa mbrojtëse -- parashikon kërkesa për
23 masa mbrojtjeje. Kjo është për qëllimet e përfshirjes të një
24 informacioni të tillë në dokumentin e dorëzimit.

25 Po i jap fjalën Z. REES.

1 Z. REES: [përmes telekonferencës][përkthim] Kemi bërë
2 shumë hetime si mbrojtje. Ato i kemi përmendur në dosjen e
3 gjerë para gjyqësore. Siç na është kërkuar, kemi dhënë një
4 listë të dëshmitarëve që për tani provizorisht kërkojmë t'i
5 ftojme, ku përcaktojmë identitetet e tyre dhe sipas temave,
6 tregohen se për çfarë çështje do të dëshmojnë ata.

7 Shpresojmë që një kërkesë e tillë që kur çështja t'i
8 paraqitet Trupit Gjykses, që do të caktohet, do të ketë seanca
9 të mëtejshme për përgatitje, kur do t'u kthehemi përsëri
10 këtyre çështjeve. Dhe hollësi të mëtejshme do të jepen në atë
11 fazë.

12 Ka disa fusha ku mund të ketë nevojë të vazhdojnë
13 hetimet. Nuk parashikojmë që kjo t'i vonojë çështjet më tej.
14 Ne ju thamë, i nderuar Gjykatës, që në fillim. Në fakt ka qenë
15 ose konferenca e parë apo e dyta, që ne do të ishim gati për
16 gjyq pak kohë mbas 30 gushtit dhe kemi arritur këtu ku kemi
17 thënë se do të ishim.

18 GJYKATËSI GUILLOU: [përkthim] Faleminderit. E mbaj mend
19 shumë mirë. Keni qenë shumë konsekuent në respektimin e
20 afateve që nga fillimi.

21 Z. Cadman, keni fjalën.

22 Z. CADMAN: [përkthim] Pa dyshim që pajtohemi me Z. Rees
23 për sa i takon afateve kohore. Sigurisht që hetimet e
24 mbrojtjes në një farë mase janë bashkërenduar midis dy ekipeve
25 dhe do të vazhdojnë të koordinohen.

1 Siç tha Z. Rees, ka shumë gjasa që hetimet do të
2 vazhdojnë edhe për një kohë tjetër, sepse ka linja hetimi që
3 duhet t'i ndjekim më tej, bazuar në perceptimin tonë. E dimë
4 që qëndrimi i ZPS-së nuk është në përputhje me ne, por ka disa
5 gjëra që ne duhet t'i hetojmë më tej dhe do të vazhdojmë të
6 bëjmë këtë punë.

7 Kemi një numër kërkesash që presim t'i bëjmë -- i kemi
8 bërë ministrive, agjencive të ndryshme në Republikën e Kosovës
9 nga të cilat kërkomë informacion. Kemi kërkuar gjithashtu dhe
10 do të vazhdojmë ta ndjekim bashkëpunimin apo kërkojmë të
11 intervistojmë një numër personash në Republikën e Serbisë për
12 shkak të përfshirjes së tyre në këtë çështje -- në këto
13 çështje.

14 Sigurisht, nëse nuk kemi bashkëpunimin e Republikës së
15 Serbisë, siç presim, për shkak të faktit që ekziston gjendje
16 lufte midis Serbisë dhe Kosovës, duhet të kthehemi këtu
17 përsëri, t'ju drejtohem për t'ju kërkuar ndihmë.

18 Ka edhe një çështje tjetër që ne do ta kërkojmë sipas --
19 do ta paraqesim në seancën private, si rezultat i atyre që
20 ndodhën javës që shkoi.

21 Gjithashtu, do të shohim edhe çështjen e dëshmitarëve të
22 tjerë që mund të kërkojnë masa mbrojtës. Por tani që flasim
23 nuk mund të japim ndonjë indikacion nëse do të kërkohet, apo
24 do të kërkojnë dëshmitarët, ndonjë formë mbrojtjeje. Këtë do
25 ta bëjmë përpara Trupit Gjykses në një fazë të mëvonshme. Por

1 besoj që duhet të ketë dëshmitarë të mbrojtjes që do të
2 kërkojnë disa masa mbrojtëse.

3 GJYKATËSI GUILLOU: [përkthim] Dhe do bëj një pyetje, se
4 mund të vlejë për Trupin Gjykues, a parashikoni se kjo ka të
5 bëjë me një apo dy dëshmitarë apo keni, ku e di unë, njëzetë -
6 - nuk e mbaj mend mirë me saktësi listën tuaj të dëshmitarëve,
7 20 e ca. Pra parashikoni këtë për shumicën e dëshmitarëve tuaj
8 apo vetëm për disa prej këtyre dëshmitarëve.

9 Z. CADMAN: [përkthim] I nderuar Gjykatës, pavarësisht që
10 dosja paraprake është dorëzuar në mënyrë konfidenciale, emri i
11 dëshmitarëve të përmendur aty , nuk kërkojmë masa mbrojtëse.
12 Megjithatë në këtë fazë nuk mund të themi -- t'i përgjigjemi
13 kësaj pyetjeje, sepse ende nuk e dimë nëse janë apo jo të jenë
14 të gatshëm, pra për të marrë pjesë. Kjo varet edhe nga dëshmia
15 që ata do të japin, do t'i drejtohem Gjykatës në momentin kur
16 ne do ta mësojmë se cili do të jetë ky qëndrim. Nuk ma merr
17 mendja që të jetë më shumë se sa 1 deri në 3 dëshmitarë por me
18 ta sqaruar këtë gjë do t'ju japim përgjigje,

19 GJYKATËSI GUILLOU: [përkthim] Faleminderit. E mbajta
20 shënim.

21 I drejtohem Prokurorit. Keni diçka për të shtuar lidhur
22 me këtë temë?

23 Z. PACE: [përkthim] Jo, I nderuar Gjykatës.

24 GJYKATËSI GUILLOU: [përkthim] Faleminderit shumë.

25 Dëshiroj tani që të kalojmë në pikën e fundit të rendit

1 të ditës, përpara se të kalojmë në seancë private, bëhet fjalë
2 për kalimin e dosjes gjyqësore Trupit Gjykues dhe gatishmërinë
3 e çështjes për gjykim. Dua të di nëse palët parashikojnë
4 ndonjë pengesë të konsiderueshme sa i takon kalimit të dosjes
5 Trupit Gjykues ditën e premte, datë 16 korrik. Në këtë aspekt
6 i kujtoj palët se kalimi i dosjes gjyqësore te Trupi Gjykues
7 nuk do të thotë me doemos hapja e çështjes për gjykim sipas
8 rregullës 14. Nevojiten hapa të mëtejshëm përgatitorë nga ana
9 e Trupit Gjykues, siç parashikohen nga rregullat 116 deri në
10 119 të rregullores.

11 Gjithsesi, dua të di nga ZPS-ja nëse pret që të jetë e
12 gatshme për të paraqitur provat e veta në gjykim në mënyrë që
13 ky informacion të përfshihet në dokumentin e dorëzimit për
14 Trupin e ardhshëm Gjykues.

15 Për të njëjtën arsye, dëshiroj që edhe Mbrojtja të
16 tregojë se kur pret se është - do të jetë e gatshme për
17 paraqitjen e provave të tyre nëse do të kenë.

18 Prokurori -- Z. Prokuror, keni fjalën.

19 Z. PACE: [përkthim] Faleminderit i nderuar Gjykatës.

20 Në fillim dua të flas për kalimin e dosjes gjyqësore.

21 Jo, nuk parashikojmë ndonjë pengesë që kjo të bëhet në datën
22 16 korrik siç është përcaktuar nga ju. Ne jemi në dijeni të
23 parashtrimeve të bëra nga -- nga mbrojtja e Z. Haradinaj.

24 Bëhet fjalë për parashtrimin F259 në paragrafin 27 ku thuhet
25 se -- Z. Haradinaj thotë se nuk është gati pra për kalimin në

1 Trupin Gjykues.

2 Aty jepen disa arsye dhe ne do të thoshim këto arsye nuk
3 janë të vlefshme. Nuk është qartë për ZPS-në se cilës kërkesë
4 i referohet Mbrojtja e Z. Haradinaj që mbetet e pa plotësuar.
5 Ne mendojmë që i kemi plotësuar të gjitha kërkesat. Sigurisht
6 do të plotësojmë edhe një kërkesë edhe nëse do të ishte e
7 paplotësuar. Për këtë arsye ne mendojmë se nuk ka asnjë
8 pengesë që kalimi i dosjes të bëhet shpejt, pra më datë 16
9 korrik. Sa i takon gatishmërisë së ZPS-së për gjykim, ne do të
10 jemi gati kur të na thuhet të jemi gati. Sigurisht, duhen bërë
11 disa hapa siç i ka shënuar Z. Gjykatës si në urdhrin e tij po
12 kështu edhe sot. Jo me doemos kalimi i çështjes do të thotë
13 fillim i çështjes gjyqësorë, gjykimit pra të çështjes
14 gjyqësorë. Në vartësi se si do të ecin gjërat edhe nga përvoja
15 jonë parashikojmë që gjykimi të fillojë në fillim të nëntorit
16 por siç e thashë, në momentin që na kërkohet që të jemi gati,
17 ne jemi gati.

18 Këto janë parashtrimet tona.

19 GJYKATËSI GUILLOU: [përkthim] Faleminderit. I kthehem
20 tani mbrojtjes.

21 Z. REES

22 Z. REES: [përmes telekonferencës][përkthim] I nderuar
23 zoti Gjykatës, ne kemi thënë tashmë se nuk shohim asnjë
24 pengesë që t'i caktohet një Trupi Gjykues çështja. Kjo
25 sigurisht përjashton problemet që do to ngrejë ekipi i

1 mbrojtjes së Z. Haradinaj në seancë private.

2 Unë do t'i drejtohem Z. Gjykatës në lidhje me këtë dhe
3 mbështes qëndrimin e tyre, por sigurisht është më mirë që Z.
4 Gjykatës ta dëgjojë këto probleme nga ekipi i Z. Haradinaj.

5 Sa i takon gatishmërisë, në vartësi të pengesave, më
6 falni në varësi të angazhimeve profesionale, siç e kemi thënë
7 edhe më përpara ne do të jemi të gatshëm për ri gjykimin duke
8 filluar nga shtatori e tutje.

9 GJYKATËSI GUILLOU: [përkthim] Faleminderit shumë.

10 Z. Cadman, fjala për ju.

11 Z. CADMAN: [përkthim] Siç e përmendi Z. PACE, ku ai
12 përmendi paragrafin 27, ku janë ngritur disa çështje nga ekipi
13 i mbrojtjes, nëse flasim për gatishmërinë për gjykim, siç e
14 kam përmendur disa herë sot, Z. Haradinaj nuk do që të vonohet
15 edhe më tej kjo çështje.

16 Ne mendojmë që çështja mund t'i kalojë Trupit Gjykses më
17 datën 16, siç e keni thënë edhe ju, siç e keni përcaktuar edhe
18 ju.

19 Ka disa aspekte që mbeten për t'u zgjidhur por nuk
20 mendojmë se këto duhet ta vonojnë edhe më tej çështjen.

21 Sa i takon urdhrin për aktakuzën e korrigjuar, kjo në
22 fakt është një çështje për të cilën kodi i procedurës penale i
23 Republikës së Kosovës ka një qëndrim krejt, krejt ndryshe.

24 Ne mund të supozojmë nga heshtja nga ana juaj që ju nuk
25 keni ndërmend që të nxirrni ndonjë vendim apo urdher tjetër

1 dhe thjesht jua ngremë këtë si aspekt, si problem dhe do të
2 donim një përgjigjen tuaj se cili është qëndrimi juaj.

3 GJYKATËSI GUILLOU: [përkthim] Kjo është e saktë.

4 Z. CADMAN: [përkthim] Sa i takon kërkesës që mbetet pa
5 plotësuar, dua që të sqaroj se për çfarë bëhet fjalë. Ka qenë
6 një kërkesë që përmbante disa kërkesa, faktikisht, që i janë
7 bërë Prokurorisë, të cilës ata i janë përgjigjur plotësisht
8 por mund të ketë një kërkesë që vjen nga kjo. Mbase mund ta
9 kem thënë gabim që do të bëhet një kërkesë e mëtejshme dhe jo
10 që është bërë një kërkesë.

11 GJYKATËSI GUILLOU: [përkthim] Faleminderit. Z. Rees,
12 Doni të thoni ju diçka? d

13 Z. REES: [përmes telekonferencës][përkthim] Po,
14 thjeshtë për të sqaruar diçka. Sigurisht, konfirmojmë që ZPS-
15 ja ka propozuar një aktakuzë të korrigjuar. Ne mbajmë qëndrim
16 që nëse kjo aktakuzë dorëzohet në formën që ka tani, është një
17 çështje të cilën duhet ta zgjidhë Trupi Gjykues. Prandaj dhe
18 ne rezervojmë të drejtë për të ngritur probleme lidhur me
19 aktakuzën e korrigjuar siç është tani, përputhet apo jo me
20 vendimin e Panelit të Gjykatës së Apelit.

21 Nuk e ngremë këtë si pengesë për kalimin e dosjes
22 gjyqësore në një Trup Gjykues të caktuar rregullisht, por dua
23 që të përmend që heshtja jonë lidhur me këtë çështje tani, kur
24 ne përndryshe jemi marrë me përfundimin e dosjes paraprahe për
25 këtë, dhe lidhur me apelin që është duke u kryer deri tani,

1 dua të them që heshtja jonë lidhur me aktakuzën e korigjuar,
2 të ndryshuar, nuk do të thotë me doemos që ne e pranojmë atë -
3 - se i përmbush kriteret e vendimit të Gjykatës së Apelit.

4 GJYKATËSI GUILLOU: [përkthim] Faleminderit shumë.

5 Z. Cadman, i qëndroni edhe ju këtij këndvështrimi?

6 Z. CADMAN: Po.

7 GJYKATËSI GUILLOU: [përkthim] I drejtohem Prokurorisë
8 nëse doni t'i përgjigjeni ndonjë argumenti nga ana Mbrojtjes.

9 Z. PACE: [përkthim] Thjesht duam t'ju informojmë se kur
10 ne kemi dorëzuar aktakuzën e korigjuar, kemi bërë edhe
11 komunikimin *inter-partes* me një version të redaktuar të kësaj,
12 që e ndihmon komunikimin dhe e ndihmon edhe shqyrtimin që i
13 bën mbrojtja këtyre korigjimeve.

14 GJYKATËSI GUILLOU: [përkthim] Faleminderit shumë.

15 Shikoj që tjetër kush nuk do të marrë fjalën për këtë
16 temë. Atëherë në këtë moment, dua t'u drejtohem palëve dhe t'u
17 pyes nëse ka ndonjë çështje tjetër që duan që të ngrenë.

18 Vë re se Mbrojtja e Z. Haradinaj ka thënë se synon që të
19 ngrejë dy çështje në seancë të mbyllur apo private. Përpara se
20 t'i dëgjomë këto çështje, nuk e di nëse ndonjë prej palëve ka
21 ndonjë çështje tjetër që do të donte të ngrinte.

22 Z. Prokuror?

23 Z. PACE: [përkthim] Faleminderit, i nderuar Gjykatës, e
24 vetmja gjë që dua të ngre ka të bëjë me çështjen e fakteve për
25 të cilat palët pajtohen. Mbrojtja në dosjen paraprake ka

1 përfshirë shënime lidhur me pikat faktike për të cilat palët
2 pajtohen. ZPS-ja - nëse preferon Gjykatësi i Procedurës
3 Paraprake mund të dorëzojë informacion Gjykatësit të
4 Procedurës Paraprake ose nëse do na thoni, përndryshe do t'ja
5 dorëzojmë këtë informacion Trupit Gjykses.

6 Edhe pse mbrojtja e Z. Haradinaj i ka renditur faktet
7 për të cilat pajtohet, mbrojtja e Z. GUCATI ka listuar vetëm
8 me numra, pa u referohet vetëm me numra dhe gjykatësit -- dhe
9 Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk është në posedim të
10 komunikimit *inter-partes*.

11 Kështu që duhet të na thoni ju se çfarë duhet të bëjmë
12 në këtë aspekt.

13 GJYKATËSI GUILLOU: [përkthim] T'i dorëzohem Mbrojtjes.
14 Nuk e di a keni kundërshtim ju që ZPS-ja nesër të dorëzojë një
15 parashtrim lidhur me këtë çështje. I drejtohem Z. Bowden,
16 paraprakisht se më duket Z. Rees nuk e kemi më të lidhur me
17 ne.

18 Z. Bowden.

19 Z. BOWDEN: [përkthim] Po, më duket se ka -- mund të
20 vështirësi me pajisjen, me telefonin. Po nuk kemi kundërshtim
21 ndaj qëndrimit të Prokurorisë.

22 GJYKATËSI GUILLOU: [përkthim] Faleminderit, Z. Bowden.

23 Z. Cadman?

24 Z. CADMAN: [përkthim] Jo, asnjë kundërshtim.

25 GJYKATËSI GUILLOU: [përkthim] Faleminderit shumë Z.

1 Cadman.

2 Atëherë Z. Pace, do të ishte shumë mirë që ta dorëzonit
3 përpara orës 4 nesër, nëse nuk është që t'ju kërkoj, në mënyrë
4 që të shpërndalet nesër pasdreke.

5 Z. PACE: [përkthim] Pa problem.

6 GJYKATËSI GUILLOU: [përkthim] Faleminderit shumë.

7 Do të kalojmë tani në seancë të private. Dua të
8 kontrolloj, Z. Rees nuk është më i lidhur me ne. Në rregull.
9 Pra nuk kemi asnjë problem që të kalojmë në seancë private.

10 Znj. Sekretare e Gjykatës, ju lutem na informoni kur të
11 kalojmë në seancë private.

12 [Seancë e private]

13 [Seancë private teksti i fshirë]

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11 [Seancë e hapur]

12 SEKRETARJA E GJYKATËS: [përkthim] I nderuar Gjykatës,
13 jemi kthye në seancë të hapur përsëri.

14 GJYKATËSI GUILLOU: [përkthim] Shoh që Z. Rees është
15 rilidhur me ne. Përpara se sa ta përfundojmë këtë seancë, ka
16 ndonjë çështje tjetër që palët dëshirojnë të ngrenë?

17 Zoti prokuror?

18 Z. Bowden, sepse më duket se u shkëput përsëri Z. REES.

19 Z. Bowden, ndonjë çështje tjetër?

20 Z. BOWDEN: [përkthim] Jo, faleminderit.

21 GJYKATËSI GUILLOU: [përkthim] Z. Cadman?

22 Z. CADMAN: [përkthim] Një gjë kam, i nderuar, ne jemi të
23 shqetësuar lidhur me faktin që çështja po zhvillohet pak a
24 shumë mbas dyerve të mbyllura. Është bërë, apo do të bëhet një
25 kërkesë që provat e Prokurorisë do të mbahen mbas dyerve të

1 mbyllura dhe ne jemi të shqetësuar lidhur me atë që
2 ngritëm në seancë private, për drejtësinë e procesit.

3 Ne do të kërkojmë që OSBE-ja apo një organ tjetër në
4 këtë pozitë të kryejë një monitorim të pavarur të procedurave
5 sepse ne jemi të shqetësuar për mënyrën se si po procedohet.

6 GJYKATËSI GUILLOU: [përkthim] Faleminderit, Z. Cadman.

7 E shënova që ju dëshiruat të ishit në seancë të mbyllur
8 dhe unë ju ftova që të kalojmë në seancë private me qëllim që
9 të jemi sa më publikë.

10 Z. CADMAN: [përkthim] Faleminderit dhe këtë na e kujtoi
11 edhe Paneli i Gjykatës së Apelit. Ka çështje të cilat duhen
12 trajtuar në seancë të mbyllur por jo tërësia e procedurave.

13 GJYKATËSI GUILLOU: [përkthim] Faleminderit.

14 E shoh që Z. Pace kërkon të marrë fjalën,

15 Z. PACE: [përkthim] Faleminderit.

16 Nuk e kuptoj këtë sugjerim që u tha -- nga doli kjo që
17 procedurat po zhvillohen të gjitha -- procedurat po zhvillohen
18 pas dyerve të mbyllura. Në qoftë se kërkojmë masa mbrojtëse,
19 për dy mbrojtës, nuk do të thotë që i gjithë gjyqi po
20 zhvillohet pas dyerve të mbyllura. Ka shumë gjëra të cilat do
21 të zhvillohen publikisht dhe ne presim me kënaqësi të
22 zhvillojmë këtë gjë në seancë, pra publike, sepse është tipar
23 themelor i një gjyqi i një gjykate, kur kërkohet që një
24 material të ri klasifikohet, etj. E kemi bërë kërkesën kështu
25 që edhe ne jemi shumë në favor, e mbështesim këtë parim shumë

1 të rëndësishëm të seancave publike.

2 GJYKATËSI GUILLOU: [përkthim] Nuk shoh dikë që të
3 kërkojë fjalën.

4 Atëherë po ju informoj se kam ndërmend që çështjen ta
5 kaloj para Trupit Gjykues më 16 korrik, të premtën, siç kemi
6 thënë më parë. Në këtë drejtim, njoftoj palët se një urdhër
7 për riklasifikime dhe versione të redaktuara publike do të
8 dalë të premtën.

9 Dhe këtu përfundon seanca e sotme. Faleminderit palëve,
10 Zyrës së Administratës për praninë, përkthyesit, stenografët,
11 teknikët dhe personelin e sigurisë për ndihmën e tyre të
12 vazhdueshme gjatë gjithë kësaj çështjeje.

13 Këtu përfundon seanca e sotme.

14 SEKRETARJA E GJYKATËS: [përkthim] Të gjithë në këmbë

15 --- Konferenca e Ecurisë së Çështjes mbyllet në
16 orën 16:10

17

18

19

20

21

22

23

24

25